

28 - 04 - 2018

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtari individual Mustaf Tahiri me procesmbajtësen Albënora Bekteshi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUE] nga Komuna Ferizaj, e akuzuar për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës me kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, të evidentuar si: PP/II.nr.1601-1/17 të datë 27 nëntor 2017, më 15 shkurt 2018 mori këtë:

### A K T G J Y K I M

PRANOHET aktakuza me kërkesë për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor, e Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, të evidentuar si: P PP/II.nr.1601-1/17 të datë 27 nëntor 2017, dhe gjykata jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

E pandehura [REDAKTUE], e lindur më [REDAKTUE] nga i ati [REDAKTUE], e emri [REDAKTUE] e gjinisë [REDAKTUE] me vendbanim në rr. [REDAKTUE] – Komuna e Ferizajt, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, studente, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, e gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal [REDAKTUE]

### ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 1 gusht 2017, rrëth orës 09:10, në rrugën e fshatit Komogllavë, Ferizaj e pandehura nga pakujdesia ka shkelur ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën e njerëzve, duke vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 48 pika 1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, ku derisa drejtonte automjetin e udhëtarëve të markës “Golf” me targa të regjistrimit [REDAKTUE] ngjyrë e verdhë, me të arritur në hyrje të fshatit Komogllavë, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve në rrugë, kthesë në të djathtë, kalon në shiritin e anës së majtë të komunikacionit dhe me

sën e përparme të anës së djathtë të automjetit, e godet në pjesën e përparme të anës së majtë të automjetin e markës "Golf", me targa të regjistrimit [REDACTED], të cilën e drejtonte [REDACTED] [REDACTED] e cila qarkullonte në kahe të kundërt të drejtimit, përvçë dëmeve në automjete, lëndie të lehta trupore me dëmtime të përkohshme të shëndetit, kanë pësuar të dëmtuarit [REDACTED] dhe [REDACTED], të pëershkruara në ekspertizën mjeko – ligjore të datës 17 nëntor 2017..

- me të cilin veprim ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga nenit 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë shënuar dhe bazuar në dispozitën e nenit 4,7,17,23,41,42.43, 46 dhe 73 të KPRK-së dhe nenit 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së të pandehurin:

#### GJYKON

**DËNIM ME GJOBË** në shumë prej dyqind (200) euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimini me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim sipas nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-së, i njëjtë do i shndërrohet në dënim burgimi, ashtu për çdo njëzet (20) € do t'i llogaritet një (1) ditë burgimi.\*

I dëmtuari [REDACTED] dhe [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna Kaçanik, për realizimin e kërkësës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë cent (60.88) €, paushallin gjyqësor në shumë prej njëzet (20) €, si dhe shumën prej tridhjetë (30) për programin përkompensimin e viktimave të krimtit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kanosjen e përmbarimit të detyruar.

#### Arsyimi

okuroria Themelore në Ferizaj, me propozim akuzën PP/II.nr.1601-1/17 të datë 27 nëntor 2017, ka akuzuar të pandehurën [REDACTED], për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragafin 1 të KPRK-së, si dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe procedura hetimore që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të propozim akuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhrit ndëshkimor në kuptim të nenit 495 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Me rastin e vlerësimit të provave materiale të bashkangjitura si në shkresat e lëndës si: akt ekspertimin mjeko – ligjor të datë 17 nëntor 2017, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugorë të datë 14 nëntor 2017, fotografat nga vendi i ngjarjes dhe prova tjera që gjinden në shkresat e lëndës, konstatoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë.

Gjykata vlerëson se këto prova janë bindëse dhe të bazuara, të cilat vërtetojnë se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet me aktakuzën e Prokurorit të Shtetit.

Konform nenit 463 paragrafi 2 të KPPRK-së, të dëmtuarit [REDACTED] dhe [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna Kaçanik, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil

Në bazë të nenit 450 të KPP-së, gjykata të akuzuari e obligoi që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 60.88 €, si dhe të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, si dhe konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimate të Krimtit taksën në shumën prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.


GJYKATA THEMELORE FERIZAJ  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL  
P.nr. 3026/17  
Datë: 15 shkurt 2018

Procesmbajtësja,

Albënora Bekteshi

Gjyqtari,

Mustaf Tahiri



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim, kësaj gjykate, në afat prej tetë (8) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

E. X. P  
15.2.18  
